

### 3. KUSHTET E PERDORIMIT TE KARTES PRIORITY PASS

Më poshtë paraqiten kushtet e përdorimit të Priority Pass.

- Titullari i kartës pranon se duke përdorur kartën, bie dakord dhe pranon kushtet e mëposhtme të përdorimit. Këto kushte përdorimi do të mbizotërojnë ndaj të gjitha termave dhe kushteve të tjera të cilat i ofrohen titullarit të kartës në lidhje me përdorimin e kartës Priority Pass.
- Karta Priority Pass nuk mund të transferohet dhe është e vlefshme deri në datën e skadencës së saj dhe nënshkrimit nga titullari i kartës. Karta nuk mund të përdoret nga asnjë person përveç titullarit të kartës dhe vetëm një kartë Priority Pass mund të përdoret për çdo vizitë në salla VIP.
- Karta Priority Pass nuk është një kartë pagese, dhe nuk është as provë besueshmërie dhe përpjekja për të përdorur atë si të tillë do të përbëjë një rast mashtrimi.
- Pranimi në salla VIP kushtëzohet nga paraqitja e një karte të vlefshme Priority Pass për person (disa kufizime mund të aplikohen për titullarët e kartës Priority Pass Select dhe titullarët ekartës Priority Pass në SHBA të cilat përfitojnë anëtarësinë nëpërmjet një institucioni financiar Amerikan). Kartat e pagesës nuk do të pranohen si karta zëvendësimi për kartën Priority Pass.
- Vizitat në sallat VIP janë subjekt i komisioneve për person dhe për vizitë. Nëse aplikohet (në varësi të planit të anëtarësimit), të gjitha këto vizita, duke përfshirë ato nga të ftuarit shoqëruar, dotë debitohej nga karta e pagesës së titullarit nëpërmjet (i) Priority Pass ose (ii) emetuesit të kartës sipas normave dhe kushteve të njoftuara nga (i) Priority Pass ose (ii) emetuesi i kartës në lidhje me anëtarësinë e tyre në Priority Pass.
- Priority Pass mund të ndryshojë komisionet për vizitat në sallat VIP në çdo kohë në bazë të një njoftimi 30 ditë përpara ndryshimit në fjalë. Nëse titullari i kartës merr kartën Priority Pass nëpërmjet një pale të tretë emetuese, të gjitha ndryshimet e komisioneve për vizitat në sallat VIP do t'i njoftohen emetuesit të kartës, i cili është përgjegjës për njoftimin e titullarit të kartës. Titullari i kartës bie dakord se Grupi i kompanive Priority Pass nuk është përgjegjës për mosmarrëveshjet që mund të lindin midis titullarit të kartës dhe emetuesit të kartës, si dhe as për humbjet që mund të pësojë titullari i kartës në lidhje me komisionet e vizitës në sallën VIP që debitohej nga emetuesi i kartës.
- Nëse titullari i kartës nuk pranon asnjë nga ndryshimet e komisioneve për vizitën në sallën VIP, titullari i kartës do të ketë të drejtë të përfundojë anëtarësinë e tij duke njoftuar me shkrim direct Priority Pass, ose emetuesin e kartës i cili do të jetë përgjegjës për njoftimin e Priority Pass dhe përgjegjës për të gjitha shpenzimet e titullarit të kartës si rezultat i mos njoftimit të Priority Pass për ndërprerjen e anëtarësisë.
- Gjatë paraqitjes së kartës Priority Pass në hyrje të sallës, punonjësi i sallës do të skanojë elektronikisht ose do të marrë emrin e kartës dhe do të lëshojë një faturë 'Regjistrim Vizite' për titullarin e kartës ose do të regjistrojë hyrjen. Titullari i kartës duhet të nënshkruajë faturën 'Regjistrim Vizite', ose do të nënshkruajë lexuesin elektronik (nëse aplikohet), i cili do të pasqyrojë numrin e saktë të të ftuarve shoqëruar, nëse ka, por nuk tregon komisionet për person dhe për vizitë. Komisioni për vizitë për titullarin e kartës, nëse ka, dhe komisioni për të gjithë personat e tjerë të ftuar do të bazohen në faturën/hyrjen 'Regjistrim Vizite' që paraqet operatori i sallës.

- Punonjësit e sallës, sipas rastit, pritojnë faturën/regjistrojnë kartën Priority Pass, dhe titullari i kartës është përgjegjës që të sigurojë se fatura/ hyrja 'Regjistrim Vizite' pasqyron përdorimin personal dhe të të ftuarve të tjerë në çdo kohë të përdorimit të sallës. Nëse aplikohet, titullari i kartës është përgjegjës që të ruajë kopjen e titullarit të kartës të faturës 'Regjistrim Vizite' që ka marrë në sallë.
- Hyrja e fëmijëve në salla dhe tarifatat për këto vizita ndryshojnë sipas sallave dhe titullari i kartës këshillohet të kontrollojë përpara udhëtimit përshkrimin individual të sallës.
- Të gjitha sallat pjesëmarrëse zotërohen dhe administrohen nga organizata, palë të treta. Titullari i kartës dhe të ftuarit shoqërues duhet të respektojnë rregullat dhe politikën e çdo salle pjesëmarrëse dhe titullari i kartës pranon që regjistrimi për një sallë nuk garanton aksesin dhe hyrjen e vazhdueshme. Titullari i kartës pranon se grupi i kompanive Priority Pass nuk kontrollon vendimin e operatorit të sallës për pranimin e titullarit të kartës, numrin e personave të lejuar për të hyrë në çdo sallë në çdo kohë, shërbimin e ofruar, orarin e hapjes/mbylljes, kohëzgjatjen që titullarët e kartës mund të kalojnë në sallë dhe komisionet që paguhen për vizita të zgjata në sallë ose personelin e punësuar në salla. Administratorët e Priority Pass do të bëjnë përpjekje të arsyeshme për të siguruar që përfitimet dhe lehtësira ofrohen sipas reklamimit të tyre, por titullari i kartës pranon se grupi i kompanive Priority Pass nuk garanton në asnjë mënyrë se të gjitha përfitimet dhe lehtësirat do të jenë të disponueshme në kohën e vizitës së titullarit të kartës.
- Gjithashtu, titullari i kartës pranon se grupi i kompanive të Priority Pass nuk është përgjegjës për asnjë humbje të titullarit të kartës ose të ftuarve të tjerë shoqërues, të cilat mund të lindin nga ofrimi ose mos-ofrimi (i plotës ose i pjesshëm) i ndonjë prej përfitimeve dhe lehtësirave të reklamuar.
- Sallat pjesëmarrëse nuk kanë asnjë detyrim të njoftojnë fluturimet dhe titullari i kartës pranon se grupi i kompanive të Priority Pass nuk do të jenë përgjegjës për asnjë humbje direkte ose indirekte që rezultojnë nëse titullari i kartës ose personat e tjerë të ftuar shoqërues humbasin fluturimin/et e tyre. Është përgjegjësia e titullarit të kartës të kontrollojë kriteret e hyrjes përkatëse për çdo vend që viziton dhe të ketë dokumentacionin e duhur të udhëtimit.
- Ofrimi i pijeve alkoolike pa pagesë (nëse lejohet nga ligji vendas) është sipas diskresionit të operatorit të çdo salle dhe në disa raste mund të jetë i kufizuar ose i padisponueshëm. Në këto raste, titullari i kartës duhet të paguajë çdo tarifë për konsumin e pijeve punonjësve të sallës. (Shikoni përshkrimet individuale të sallave për detaje.)
- Shërbimet e telefonit dhe internetit Wi-Fi (nëse ofrohen) ndryshojnë nga salla në sallë dhe ofrohen sipas diskresionit të operatorit të sallës. Përdorimi pa pagesë i shërbimeve telefonike në përgjithësi kufizohet vetëm me telefonatat lokale. Komisionet për çdo shërbim tjetër janë sipas diskresionit të operatorit të sallës dhe titullari i kartës është përgjegjës për kryerjen e pagesës direkt stafit të sallës.
- Pranimi në salla lejohet vetëm për titullarët e kartave dhe të ftuarve të tjerë të cilat zotërojnë një biletë të vlefshme fluturimi dhe dokumenteve të udhëtimit për të njëjtën ditë udhëtimi. Punonjësit e linjës ajrore, aeroportit, ose industrive të tjera të udhëtimit të cilët udhëtojnë me bileta me çmim të reduktuar nuk mund të lejohen të hyjnë. Jashtë SHBA, biletat e fluturimit duhet të jenë të shoqëruara me një leje kalimi të vlefshme (boarding pass) për një fluturim në nisje, p.sh. vetëm për pasagjerë në nisje. Ju informojmë se disa prej sallave në Europë ndodhen në zona të

caktuara Shengen të aeroportit, që do të thotë se hyrja lejohet vetëm në ato salla nëse titullarët udhëtojnë në vendet Shengen (një listë e përditësuar e vendeve Shengen paraqitet në mënyrë të detajuar në sajtin [http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/what-we-do/policies/bordersand-visas/schengen/index\\_en.html](http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/what-we-do/policies/bordersand-visas/schengen/index_en.html) )

- Pranimi në salla lejohet vetëm për titullarët e kartave dhe të ftuarit e tjerë (përfshirë fëmijët) të cilët sillen dhe vishen në përputhje me kushtet përkatëse të sallës dhe çdo person i cili nuk plotëson këto kushte mund t'i kërkohet të largohet nga mjediset e sallës. Kompanitë e grupit Priority Pass nuk janë përgjegjëse për humbjet që pëson titullari i kartës dhe personat e tjerë të ftuar nëse operatori i sallës refuzon pranimin për arsye se titullari i kartës dhe/ose personat e tjerë të ftuar nuk plotësojnë këto kushte.
- Deri në masën e plotë të parashikuar në ligj, grupi i kompanive Priority Pass nuk mban asnjë përgjegjësi për veprimet e titullarit të kartës gjatë përdorimit të sallës pjesëmarrëse dhe nuk do të mbajë përgjegjësi për sendet personale që titullarët e kartës mbajnë në sallë.
- Humbja, vjedhja ose dëmtimi i kartave Priority Pass duhet t'i njoftohet menjëherë (i) zyrës së Priority Pass e cila ka emetuar kartën ose (ii) emetuesit të kartës të cilët do të jenë përgjegjës për zëvendësimin e kartës. Për çdo zëvendësim karte do të aplikohet një komision.
- Nëse titullari i kartës anulon ose nuk rinovon anëtarësinë në Priority Pass ose pagesën e kartës me emetuesin e kartës, karta Priority Pass do të jetë e pavlefshme duke filluar nga data e anulimit ose nga data e skadencës së afatit të anëtarësisë së tyre në Priority Pass (siç aplikohet) ose të kartës së tyre të pagesës. Të gjitha vizitat e titullarit të kartës në salla me një kartë të pavlefshme, duke përfshirë dhe personat e ftuar, do t'i faturohen titullarit të kartës. Në rast se anëtarësia e Priority Pass është revokuar për shkak të anulimit të kartës së pagesës së titullarit të kartës, Priority Pass ka të drejtën të ndjekë procedurën ligjore për të rikuperuar të gjitha komisionet e papaguara. Anulimi i anëtarësisë duhet të jetë me shkrim drejtuar Priority Pass.
- Termat dhe kushtet e rinovimit janë në diskrecionin e Priority Pass. Priority Pass gëzon të drejtën për të refuzuar anëtarësinë personave të cilët janë të punësuar ose kanë një kontratë me shoqërinë ajrore, aeroportin ose qeverinë për sigurinë e linjës ajrore ose aeroportit.
- Nëse titullari i kartës bie dakord për faturimin automatik, anëtarësia në Priority Pass do të rinovohet automatikisht nëse titullari i kartës nuk anulon anëtarësinë me shkrim, të paktën 30 ditë përpara përfundimit të anëtarësisë.
- Nëse titullari i kartës bie dakord për faturimin standard, anëtarësia e Priority Pass do të përfundojë nëse titullari i kartës nuk informon Priority Pass në lidhje me dëshirën e tyre për të rinovuar anëtarësinë e tyre me shkrim përpara përfundimit të afatit të anëtarësisë.
- Grupi i kompanive të Priority Pass nuk do të mbajë përgjegjësi për mosmarrëveshjet ose pretendimet të cilat mund të lindin midis titullarit të kartës dhe/ose personave të tjerë të ftuar dhe operatorit të sallës. Të gjitha mosmarrëveshjet duhet të zgjidhen direkt me sallën në fjalë dhe grupi i kompanive të Priority Pass nuk do të jetë përgjegjës për kostot, dëmtimet ose shpenzimet përkatëse që lidhen më këto mosmarrëveshje.
- Grupi i kompanive të Priority Pass gëzon të drejtën në çdo kohë sipas diskresionit të tij dhe pa njoftim të revokojë anëtarësinë në Priority Pass ose të ndërpresë programin Priority Pass. Nëse aplikohet, do të ketë një kompensim proporcional të tarifës vjetore/tarifës së regjistrimit (cilado

qoftë e aplikueshme) me kusht që revokimi të mos jetë bërë për shkak të mashtrimit ose keqpërdorimit nga ana e titullarit.

- Titullari i kartës bie dakord se do të mbrojë dhe zhdëmtojë grupin e kompanive të Priority Pass, drejtuesit e saj, nëpunësit, punonjësit dhe agjentët (së bashku referuar “palët e zhdëmtuara”) si dhe duhet të mbrojë çdo palë të zhdëmtuar nga të gjitha detyrimet, humbjet, pretendimet, paditë, gjykimet, kostot dhe shpenzimet (duke përfshirë tarifën e arsyeshme ligjore) për lëndimin ose vdekjen e një personi ose dëmtimin apo shkatërrimin e pronës që rezulton nga përdorimi i çdo salle ose ndonjë person tjetër që shoqëron titullarin e kartës, përveç faktit që ky zhdëmtim nuk do të shtrihet në akte neglizhencë ose sjellje e qëllimshme nga palët e zhdëmtuara.
- Priority Pass nuk bën asnjë deklaram në lidhje me të ardhurat, përdorimin, akcizën ose detyrime të tjera tatimore të titullarëve si rezultat i anëtarësimit të tyre në Priority Pass. Titullarët e kartave këshillohen të kontaktojnë llogaritarin ose konsulentin tatimor për informacione të mëtejshme. Titullari i kartës është vetë përgjegjës për të gjitha detyrimet tatimore të cilat rezultojnë nga anëtarësia e Priority Pass.
- Nëpërmjet përdorimit të kartës Priority Pass, titullari i kartës jep pëlqimin për përdorimin e të dhënave në përputhje me politikën e privatësisë së Priority Pass e cila disponohet në [www.prioritypass.com](http://www.prioritypass.com) ose mund të disponohet në bazë të një kërkesë me shkrim drejtuar Priority Pass at Cutlers Exchange, 123 Houndsditch, London EC3A 7BU, UK.
- Duke vendosur detajet e kartës për pagesën e tarifës vjetore të anëtarësisë, titullari i kartës pranon se këto detaje të kartës do të përdoren për kryerjen e pagesës për të gjitha vizitat në sallë sipas normës që mbizotëron.
- Grupi i kompanive Priority Pass vazhdimisht bën përpjekje për përmirësimin e shërbimeve që u ofron titullarëve të kartave. Të gjithë titullarët e kartave që kanë problem ose ankesa mund të kontaktojnë Priority Pass. Priority Pass herë pas here mund të monitorojë thirrjet telefonike nga titullarët e kartave për të ruajtur dhe përmirësuar shërbimet e saj. Të gjitha ankesat në lidhje me vizitën në sallë duhet të bëhen brenda një periudhe gjashtë mujore nga vizita përkatëse në sallë.
- Priority Pass gëzon të drejtën që të ndryshojë në çdo kohë Kushtet e Përdorimit duke njoftuar në mënyrë të arsyeshme titullarët e kartës në përputhje me rrethanat.
- Deri në masën e lejuar nga ligji ose rregullorja lokale, Kushtet e Përdorimit do të rregullohen dhe interpretohen në përputhje me legjislacionin anglez. Priority Pass dhe titullari i kartës do t’i drejtohen juridiksionit jo-ekskluziv të gjykatave angleze për të zgjidhur mosmarrëveshjet që lindin prej tyre.
- Çdo dispozitë e këtyre Kushteve të Përdorimit e cila deklarohet e pavlefshme ose e pazbatueshme nga çdo autoritet ose gjykatë kompetente, do të konsiderohet, deri në masën e kësaj pavlefshmërie dhe pazbatueshmërie, e ndashme dhe nuk do të cenojë dispozitat e tjera të Kushteve të Përdorimit.
- Nëse ekziston ndonjë mospërputhje midis versionit të gjuhës angleze të Kushteve të Përdorimit dhe versionit ose përkthimit të Kushteve të Përdorimit në gjuhën lokale, versioni në gjuhën Angleze do të mbizotërojë.